



Prishtinë, 28 janar 2019
Kodi i ZRRE-së: V_1092_2019

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7, nenin 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.15, nenin 25, nenin 26 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 dhe nenin 43 paragrafi 1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084),
- Nenin 25 të Rregullës Nr. 11/2017 për Procedurën e Autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja bazuar në Burimet e Ripërtrishme të Energjisë,
- Nenin 18, 19 dhe 20 të Rregullës Nr. 10/2017 për Skemën Mbështetëse për Gjeneratorët e BRE-ve,dhe
- Aplikacionin për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë-konsum nga panelet solare/fotovoltaike, në Lokacionin Rruga "Ilir Soba", me kapacitet të instaluar prej 4.88 kW në Komunën e Gjakovës, të datës 09.01.2019 me nr. prot. 322/2019 të aplikuesit Sahit Imeri, me adresë: Rruga "Ilir Soba", Komuna e Gjakovës, Republika e Kosovës.

në seancën e mbajtur më 28 janar 2019 nxori këtë:

V E N D I M

PËR NDËRTIMIN E KAPACITETEVE GJENERUESE PËR VETË-KONSUM

- I. APROVOHET-** kërkesa e aplikuesit Sahit Imeri për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë – konsum nga panelet solare/fotovoltaike, në Lokacionin rruga "Ilir Soba", me kapacitet të instaluar prej **4.88 kW**, mbi kulmin e shtëpisë, Komuna e Gjakovës.
- II. OBLIGOHET** – aplikuesi Sahit Imeri me shifër të regjistruar të njehsorit elektrike DGJ-35068 që pas ndërtimit të kapaciteteve të reja gjeneruese për vet-konsum, të parashtrij kërkesë në KEDS SH.A., për pranimit teknik të objektit energjetik.
- III.** ZRRE do të konsideroj projektin e finalizuar nga data e pranimit teknik sipas Pëlqimit Elektroenergjetik të lëshuar nga KEDS SH.A.
- IV.** Aplikuesi Sahit Imeri do të lidh Marrëveshje për vet-prodhim me furnizuesin me të cilën ka kontratë për furnizim me energji elektrike, pas konfirmimit të pranimit teknik nga KEDS SH.A., në pajtim me nenin 18 paragrafi 1 dhe 2 i Rregullës Nr. 10/2017 për Skemën Mbështetëse.

A r s y e t i m

- o ZRRE, me datë 09.01.2019 nga aplikuesi Sahit Imeri ka pranuar aplikacionin për marrjen e vendimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë – konsum nga panelet



solare/fotovoltaike, në Lokacionin rruga "Ilir Soba", me kapacitet të instaluar prej **4.88 kW**, mbi kulmin e shtëpisë, shifra e konsumatorit DGJ -35068, Komuna e Gjakovës.

- Aplikuesi, s'bashku me aplikacioni ka bashkangjitur edhe dëshminë nga KEDS për konsumin vjetorë të energjisë elektrike, vlerësimin për prodhimin vjetor në kW/h të pajisjeve të instaluara, pëlqimin elektroenergjetik nr. 11420 të datës 20.10.2018 të lëshuar nga KEDS SH.A., Lejen për Hyrje nr. 13814 të datës 13.12.2018 të lëshuar nga KEDS SH.A., projektin final ekzekutues dhe përgjigjen nr. 07-353/01-2993 të lëshuar nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Komuna e Gjakovës.
- Bordi i ZRRE-së, pas analizimit të kërkesës së aplikuesit Sahit Imeri, dhe dëshmime të bashkangjitura, për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë - konsum nga panelet solare/fotovoltaike në Lokacionin rruga "Ilir Soba" - mbi kulmin e shtëpisë, me kapacitet të instaluar prej **4.88 kW**, ka vlerësuar ato, dhe ka konsideruar se janë plotësuar të gjitha dëshmitë relevante për lëshimin e vendimit për ndërtimin e kapaciteteve gjeneruese për vetë-konsum, dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij Vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.

V. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

VI. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Arsim Janova, u.d. Kryesues

Besim Sejfiqaj, anëtar

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- Palës,
- Komunës së Gjakovës,
- KEDS SH.A., dhe
- Arkivit të ZRRE-së